

Punëtori mbi Marëdhëniet me Publikun I

19 Prill, 2013

Prishtinë, Kosovë



LLOJET E ARTIKUJVE

Ekzistojnë lloje të ndryshme të artikujve, por katër prej tyre janë më të njohura në të gjithë botën:

- Lajme
- Analizë e Lajmeve
- Storie
- Opinion



LAJME

- Bazuar plotësisht/vetëm në fakte
- Përmban shumë detaje
- I shmanget opinionëve personale
- Zakonisht është i shpejtë në kohë dhe duhet të jetë lajm i ri



ANALIZË E LAJMEVE

- Bazuar në fakte
- Spjegon ngjarjen dhe e vë në kontekst
- ka një drejtim, por bazohet në fakte
- Ato duhet të jenë informuese dhe të balancuara

- Nuk ka opinion personal
- Gjithcka që raportohet duhet të jetë fakt
- Faktet duhet të kreditojnë burimin
- Analiza duhet të bazohet në këto fakte
- Nëse kuotoni një burim për të cuar më tej një opinion, atëherë duhet të mirret edhe një këndvështrim nga një tjetër burim.



ANALIZË E LAJMEVE

- Detaje:
 - Gjithmonë shkruhet në vetën e tretë (p.sh., 'RrGGK' në vend se 'NE')
 - Fjali dhe paragrafe të shkurta
 - Gjithmonë një ose dy fjali në paragrafin e parë (dhe të dytin), ndërsa në paragrafet e mëposhtme deri në tri ose katër fjali për paragraf
 - Fjalitë të jetë jo më e gjatë se 25 fjalë
 - Të shtjellohet një ide në një paragraf
 - Stili piramid: faktet më të rëndësishme lart, ndërsa të tjerat më pak të rëndësishme në fund.



STORIE

- Tregon një storie
- Është shumëgjyreshe me spjegim të detajuar
- Zakonisht është më e gjatë
- Ky shkrim duhet të sjellë lexuesin direkt tek stória, sikur lexuesi të jetë duke lexuar nëpërmjet syve të gazetarit



OPINION

- Nuk duhet:
 - Të shprehësh zemërimin
 - Të shkruash atë që ndjen
 - Nuk është vend për emocione
- Duhet të përmbaj:
 - Opinion personal
 - Dicka të rëndësishme për të treguar
 - Të zhvilloj një argument të besueshëm
 - Të ketë një zë të vecantë dhe një stil personal



SI TË SHKRUAJMË NJË KUMTESË PËR MEDIA

- Informatat kyqe / template:

- Logo – emri i organizatës
- Adresa
- Numri i telefonit
- E-maili
- Kontakt personi

p.sh.,

Për më shumë informata ju lutemi kontaktoni *Emër Mbiemër*



TITULLI DHE NËNTITULLI

- Titulli

- Nuk duhet të jetë shumë i gjatë (vetëm një rresht)
- Duhet të jetë koha e tashme

p.sh., *RrGGK organizon trajnim mbi Marëdhëniet me Publikun në vend se RrGGK ka organizuar trajnim mbi Marëdhëniet me Publikun* (përmban folje dhe emër)

Mbani mend: të njejtat rregulla vlejnë edhe për tekstin që shkruhet nën foto.

- Nëntitulli

- Është opcionale
- Mund të jetë më e gjatë, deri në 2 rreshta
- Duhet të përmbajë spjegim më të detajuar dhe të mos thuhet e njëjta gjë si në titull



TITULLI DHE NËNTITULLI

- Shembull:

Titulli: “RrGGK Organizon Ecje, Peticion për të dënuar vrasjen e Dianës”

Nëntitulli: Mbi 200 Njerëz Ecin tek Gjykata Komunale, 638 Nënshkruajn Peticionin për të Kërkuar Drejtësi

“RrGGK Organizon Ecje, Peticion për të dënuar vrasjen e Dianës”

Mbi 200 Njerëz Ecin tek Gjykata Komunale, 638 Nënshkruajn Peticionin për të Kërkuar Drejtësi



PJESËT KRYESORE TË ARTIKULLIT

Tri pjesët kryesore të një artikulli janë:

- Fjalë Hyrëse
- Përmbajtja (body); dhe
- Konkluzioni (fjalë mbyllëse)

Secili detaj është i rëndësishëm kur kumtesa dërgohet tek mediat, pasi që gazetarët në të shumtën e rasteve nuk shikojnë përmbajtjen por vetëm e publikojnë. Prandaj kumtesa nuk duhet të ketë gabime, pakjartësi etj.



FJALIA HYRËSE

KUSH?

CKA?

KU?

KUR?

- Fjalja hyrëse është hapja e një artikulli.
- Qëllimi është: të marrim menjëherë vëmendjen e lexuesit; të tregojmë gjithë storien me një fjali (më së shumti dy);



FJALIA HYRËSE

Shembuj (Kush, Cka, Ku, Kur?):

Pasi që dje e kishin ndjekur veturën e tij nëpër rrugët e Budvës për shkak të shpejtësisë së tejkaluar, Policia arrestoj një gazetar 45 vjecar dhe e dënoi për shpejtësi.

RrGGK organizoj Ecjen ku u ftuan të gjithë qytetarët për të dënuar këtë vrasje që shqetësoi jo vetëm qytetarët e Kosovës por edhe neve si RrGGK, e cila u mbajt më 20 Maj 2011. Mbi 200 qytetar u mblodhën tek ndërtesa e Qeverisë, afër Teatrit Kombëtar, për të vazhduar më tej ecjen në mënyrë solemne deri tek Gjykata Komunale e Prishtinës, ku ndezën qirinjë në kujtim të Dianës.



Përmbajtja (Body)

PSE?

SI?

- Artikulli mund të jetë në kohën e shkuar, ndonjëherë në kohën e ardhshme
- Duhet t'i kushtojmë vëmendje presjeve, shenjave të pikësimit, hapsirave në mes të fjalëve

Shembull:

Gratë dhe burrat ngritën zërin e tyre për të kërkuar drejtësi për dhunën në familje ..

Gratë dhe burrat ngritën zërin e tyre, për të kërkuar drejtësi për dhunën në familje.



Përmbajtja (Body)

- Këtu ofron më shumë detaje
- Secili paragraf duhet të ndjekë logjikën e paragrafit paraprak, që lexuesi ta ketë më të qartë të gjithë artikullin
- Informatat e panevojshme, përsëritjet e fjalive dhe fjalitë e gjata humbin vëmendjen e lexuesit

Shembull:

Përkundër faktit që Kastrati kishe kërkuar urdhëresë për mbrojtje, Gjykata Komunale në Prishtinë ka dështuar t'i përgjigjej kërkeses brenda 15 ditëve. Në këtë rast Gjykata Komunale, ka dështuar në përmbushjen e detyrave ligjore në përputhshmëri me Ligjin e lartpërmendur (Neni 15.1).



KONKLUZIONI

- Është fundi i artikullit
- Nuk është vendi për më shumë informata
- Mundohu të rikujtosh lexuesin se pse ky artikull është i rëndësishëm
- Është mundësia e juaj e fundit për të lënë një përshtypje të mirë

Shembuj:

RrGGK do të vazhdojë të ndjekë këtë dhe raste të tjera të dhunës në familje. Në të njëjtën kohë ne u bëjmë thirrje qytetarëve që të mos qëndrojmë indiferent dhe të heshtur ndërsa ndaj motrave tona ushtrohet dhunë dhe ato vriten; që të raportojmë dhunën që e vrejme; t'ua dëshmojmë njerëzve që ende gjenden në mjedise ku ushtrohet dhunë, se nuk janë vetëm dhe se të gjithë ne i përkrahim ata.

I përgëzojmë organizatat anëtare të Rrjetit të cilat përfituan grante në këtë raund dhe shpresojmë në mundësinë e përkrahjes së organizatave të tjera në të ardhmen.



JU FALEMNDERIT

